




REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESI E MADHE

Nr. 3234/prot

Koplik më: 07/10 /2021

Këshillit të Bashkisë Malësi e Madhe
Propozim për dhënie titulli “ Qytetarë Nderi “ i Bashkisë Malësi e
Madhe At Gjergj Fishta (pas vdekjes)



Gjergj Fishta (Fishtë, 23 tetor 1871 - Shkodër, 30 dhjetor 1940) ka qenë frat françeskan, arsimtar, shkrimtar, përkthyes dhe po ashtu kryetar i komisionit për hartimin e alfabetit në Kongresin e Manastirit 1908, anëtar i delegacionit të qeverisë Përmeti në Konferencën e Versajës dhe zëvendëskryetar i legjislavitit shqiptar më 1921. Pas dekadës së dytë të shekullit 20, Fishta iu imponua kulturës shqiptare jo vetëm si shkrimtar (poet, dramaturg, prozator etj.), por edhe si kritik, historian i letërsisë dhe estet. Për një gjysmëshekull, ishte figura mbizotëruese e letërsisë shqipe, madje sa ishte gjallë u kurorëzua "**Poet Kombëtar**".

At Gjergj Fishta ishte shqiptari i parë i cili ka mundur të bëjë skicën e parë detajuese më së shumti antropometrike nepërmjet përshkrimve të personazheve të tij tek poema "**LAHUTA E MALËSISË**" që i kushtohet totalisht trevës tone Malësi e Madhe duke i dhënë edhe vlerësimin **HOMERI I SHQIPËRISË**.

Ne i jemi mirënjohës At Gjergj Fishtës në këtë 150 vjetorë të lindjes së tij për gjitha sa ai kontribuoi si atdhetarë, shkrimtarë e si një ndër përfaqësuesit më të denjë të krenarisë Kombëtare Shqiptare.

Për gjitha sa thamë më lartë i propozohet Këshillit Bashkiak Malësi e Madhe ti jepet titulli " Qytetarë Nderi " i Bashkisë Malësi e Madhe me

motivacion:

"Një nga personalitetet më të shquara të atdhetarisë e historisë, artit e kulturës, letërsisë e publicistikës shqiptare e më gjërë, mbrojtës i denjë i Alfabetit të Gjuhës Shqipe në Kongresin e Manastirit 1908 e sidomos me botimin e poemës "Lahuta e Malësisë" lartësoj kurdoherë trevën tonë Malësi e Madhe".

